



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
SANKSIONEVE

Data: 14 Shtator 2022

Nr: 22

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE NR.
02, DATË 15.07.2022 DREJTUAR KOMISIONIT TË ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE,
PËR VENDOSJE SANKSIONI ADMINISTRATIV

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 15.09.2022, me pjesëmarrjen e:

Koli BELE	-	Relator
Elvin LAKO	-	Anëtar
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Ilijan RUSMALI	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Në prani të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga administrata e KQZ-së,

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

OBJEKTI: Vendosja e sanksionit administrativ ndaj zj. Majlinda Angoni, kandidate për kryetar të bashkisë Shkodër, për zgjedhjet e pjesshme të datës 06 Mars 2022 dhe zj. Edona Tafa, drejtor dhe mjek në Qendrën Shëndetësore Rrethina, Ambulanca “Dobraç”

BAZË LIGJORE: Bazuar në nenet 21, pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; neni 34, shkonja “b” dhe neni 35 të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”; vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Rrethanat e çështjes:

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vënë në lëvizje Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve me kërkesën e tij nr.2, datë 15.07.2022, me objekt vendosjen e sanksionit administrativ ndaj kandidates për kryetare bashkie për Bashkinë Shkodër, të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, në zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 mars 2022 dhe ndaj drejtores së Qendrës Shëndetësore “Rrethina”, Ambulanca Dobraç.
2. Kërkesa u paraqit në përfundim të hetimit administrativ të kryer nga Komisioneri bazuar në denoncimin me nr. ID 3671 të datës 4 Mars 2022, të depozituar në portalin e denoncimeve nga organizata “Qëndresa Qytetare” kundër subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, zj. Majlinda Angoni, kandidate e Partisë Socialiste për Kryetare në Bashkinë Shkodër, dhe zj. Edona Tafa, drejtore dhe mjekë në Qendrën Shëndetësore “Rrethina”, Ambulanca Dobraç. Qëndresa Qytetare denonconte subjektet e sipërcituar për shkelje të dispozitave të nenit 91, pikat 1 dhe 2, të Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, përkatësisht neni 3 pikat 1.3/c dhe 1.3/ç, për shkak se nëpërmjet një spoti elektorale ku shfaqet mjekja Edona Tafa, i cili është publikuar në faqen zyrtare të kandidates së PSSH janë vënë në mbështetje të kandidates, burime të organeve publike sikurse është Qendra Shëndetësore “Rrethina” Ambulanca Dobraç.
3. Hetimi administrativ i kryer nga Komisioneri ka provuar dhe palët e referuara kanë pranuar, se fakti juridik objekt shqyrtimi ka lidhje me një kompozim në video dhe në audio i realizuar nga mjekja në mjediset e qendrës shëndetësore, një aseti publik, me qëllimin për t’i ardhur në ndihmë kandidates në fushatën elektorale për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 Mars 2022. Pretendimi i palëve të denoncuar ka qenë se video, sikurse referohet në denoncim, nuk është bërë brenda

orarit zyrtar të punës, por në orën 17:00 dhe se nuk është cënuar asnjë lloj interesi publik, interes shëndetësor apo grup individesh. “Gjatë kompozimit të videos për spotin elektoral, gabimisht është përdorur emri i Qendrës Shëndetësore”. Këto pretendime nuk janë konsideruar relevante nga Komisioneri për analizën e tij ligjore.

4. Pas paraqitjes së kërkesës nr.2, datë 15.07.2022 të komisionerit, KAS-i caktoi me short anëtarin Koli Bele relator të çështjes dhe në seancën e datës 27.05.2022, e cila u zhvillua me praninë e sekretarit të përgjithshëm të KQZ-së, të përfaqësuesit të organizatës “Qëndresa Qytetare” z. Rigels Xhemollari dhe të Av. Maringlen Legisi përfaqësues me prokurë i kandidates për kryetare të bashkisë Shkodër zj. Majlinda Angoni, (zj. Edona Tafa e njoftuar rregullisht, në mungesë) vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim dhe caktimin e seancës së shqyrtimit në datën 14.09.2022, ora 11:00.
5. Në seancën e shqyrtimit u paraqitën dhe parashtruan pretendimet e tyre:
 - administrata e KQZ-së, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm Ylli Merkaj;
 - avokat Maringlen Legisi, përfaqësues me prokurë i zj. Majlinda Angoni;
 - organizata “Qëndresa Qytetare”, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv, z. Rigels Xhemollari.
 - Zj. Edona Tafa e njoftuar rregullisht nga administrata e KQZ-së, në mungesë
6. KAS-i mori në shqyrtim, këqyri dhe administroi me cilësinë e provës:
 - denoncimin nr. ID 3671 të datës 4 Mars 2022 të organizatës “Qëndresa Qytetare”;
 - vendimin e Komisionerit nr. 182, datë 30.06.2022;
 - deklaratimet e përfaqësuesve të palëve në seancë.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

KAS-i konstatoi:

1. Rrethanat e faktit, sikurse u prezantuan nga palët gjatë procedurës së shqyrtimit në themel që u zhvillua nga KAS-i kanë zbuluar disa elementë thelbësorë, të cilat modifikojnë cilësimin juridik të shkeljes së pretenduar. Objekt shqyrtimi përpara Komisionerit ka qenë një material promociional i parapërgatitur (video) me protagoniste mjeken Edona Tafa. Ky material është

prodhuar në sfondin e institucionit ku punon protagonistja dhe duket se është bërë me qëllimin e qartë për të evidentuar qenien e saj mjekë në këtë institucion, në Qendrën Shëndetësore “Rrethina”, Ambulanca Dobraq. Nga hetimi i Komisionerit ka rezultuar se ky material promociional është përgatitur “me qëllimin për t’i ardhur në ndihmë kandidates në fushatën elektorale për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 Mars 2022”. Në këtë kontekst, mjedisi ku është bërë filmimi (regjistrimi video) ka rëndësi për qëllimin e deklaruar. Në sfond të materialit promociional është mbajtur pamja e qendrës shëndetësore dhe protagonistja ka identifikuar veten vizualisht si mjekë, me gjasë për t’i dhënë peshë mesazhit të vet, sepse fjala e mjekut, si rregull, ka peshë mbi zgjedhësit.

2. Por rrethanat e faktit, të cilat mbështeten nga deklaratimet e denoncuesve në seancë, zbulojnë se ky material promociional është përgatitur nga mjekja dhe është publikuar prej saj fillimisht në llogarinë personale në median sociale *Facebook* dhe vetëm pas kësaj është bashkëndarë nga llogaria e zyrtare e kandidates në të njëjtin rrjet mediatik. Kjo rrethanë nuk mund të injorohet nga hetimi administrativ, sepse ajo e shndërron përdorimin e asetit publik (qendrës shëndetësore) nga përdorim për llogari të subjektit zgjedhor në përdorim për nevoja private. Postimi në llogarinë private i shërben qëllimeve për të cilat mbahet një llogari private. Mbajtësja e llogarisë ka promovuar/zbuluar/deklaruar veten si votuese e kandidates së PSSH-së, gjë që mbështetet dhe nga mesazhi i saj në këtë material promovues: “...Jam e bindur se një grua multidimensionale si zj. Majlinda Angoni që e ka sprovuar veten në shumë fusha me sukses, është zgjedhja e duhur për një bashki të shkodranëve. Unë votoj Majlinda Angoni...”. Bashkëndarja e një postimi të një llogarie private nga llogaria e kandidates e lidh këtë të fundit me mesazhin promovues (bashkëndarja do të thotë pëlqim, mbështetje, miratim) por nuk e shndërron atë në përdoruese të aseteve publike që janë shfrytëzuar gjatë përgatitjes së mesazhit. Sa kohë që prova e vetme që implikon kandidaten për kryetare bashkie është bashkëndarja/postimi i videos private, KAS-i nuk mund ta bëjë atë përgjegjëse për përdorim të aseteve shtetërore.
3. Materiali i përgatitur nuk përmban mesazh të kandidates, nuk ka gjurmën e autorësisë së kësaj të fundit, apo të subjektit zgjedhor që e mbështet. Materiali i përgatitur ka vetëm gjurmën e autorësisë së protagonistes. Për këtë arsye, KAS nuk mund veçse të pranojë se përdorimi i asetit publik (shfrytëzimi i mjediseve të qendrës shëndetësore si sfond i veprimit të protagonistes) është bërë vetëm nga protagonistja, për llogari të vet dhe në shërbim të interesave të veta. Qendrimi do duhet të ishte i kundërt nëse kandidatja ose subjekti zgjedhor

që e mbështeste atë do kishin gjurmën e tyre në materialin e përgatitur. P.sh. prezenca e kandidatës në të njëjtin mjedis me protagonisten ose, anasjelltas, protagonizimi i kandidatës në prezencën e mjekes në të njëjtin mjedis, përcjellja ose shfaqja e mesazheve zgjedhore të kandidatës, apo të subjektit mbështetës, bashkëautorësia e materialit promovues, postimi i tij jo në llogarinë private të protagonistes, por në llogarinë zyrtare të kandidatës etj., të gjitha këto do të formonin elementë që thërrasin në përgjegjësi administrative edhe kandidaten, ose vetëm kandidaten. Por deklaratimet e palëve në seancë provuan se këto rrethana mungojnë.

4. Kodi zgjedhor në nenin 5 ka ndaluar përdorimin e “forcave dhe strukturave të posaçme të policisë” si dhe specifikisht pjesëmarrjen e punonjësve të Shërbimit Informativ në fushatën zgjedhore. Po ashtu, në nenin 62 ka rregulluar papajtueshmërinë e kandidimit me disa pozicione publike dhe administrative. Pjesëmarrja e qytetarëve, punonjës në sektorin publik në jetën politike duke mbështetur kandidatë apo subjekte zgjedhore është e drejtë e tyre e garantuar nga Kushtetuta.
5. Ligjvënësi në nenin 91, pika 1 të Kodit Zgjedhor ka normuar ndalimin e përdorimit të “burimeve publike” për qëllime zgjedhore. Në vijim, në pikën 2 ka përcaktuar së çfarë do të thotë termi “burime”, duke i ndarë ato në asetet e luajtshme dhe të paluajtshme sipas parashikimit të nenit 142, të kodit Civil, si dhe “burime njerëzore” kur kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës. Në mesazhin mbështetës të Dr. E. Tafa, pavarësisht se ajo ka dalë në zyrën e saj, nuk jemi para “përdorimit” të asetit, pasi mesazhi ka të bëjë më qëndrimin individual të personit ndaj një kandidati. Ndryshe, do ishte rasti nëse në cilësinë e saj si mjekë apo drejtuese e qendrës shëndetësore do të organizonte një aktivitet elektoral në sallën/ambientet e institucionit publik, (*shif Vendimin nr.103, datë.14.07.2021 të KAS-it, rasti i organizimit të aktivitetit elektoral brenda mjedisëve të një shkolle publike*), apo do të organizonte pjesëmarrjen e stafit të qendrës në formën e “përdorimit të detyruar” në një aktivitet elektoral.
6. KAS-i nuk mund të analizojë nëse zj. Edona Tafa ka përgjegjësi administrative apo etike në raport me detyrën, për regjistrimin e një video mesazhi në ambientet e punës për qëllime private, sepse kjo është jashtë tagrave të KAS-it. Kontrolli dhe llogaridhënia duhet të ndodhin brenda sistemit dhe janë përgjegjësi e organeve eprore të drejtoreshës së qendrës shëndetësore.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në arsyetimin e mësipërm ligjor dhe bazuar në shkronjën “dh” të pikës 1 dhe në pikën 3 të nenit 21 të Kodit Zgjedhor, KAS-i me shumicë votash

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës së Komisionerit për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj kandidates për kryetare të Bashkisë Shkodër, zj. Majlinda Angoni;
2. Rrëzimin e kërkesës së Komisionerit për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj zj. Edona Tafa, drejtoare e Qendrës Shëndetësore “Rrethina, Ambulanca Dobraç.
3. Pushimin e procedimin administrativ lidhur me denoncimin me nr. ID unik 3671 të datës 4 Mars 2022, të raportuar në portalin e denoncimeve në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar (Kundër)
Ilirjan	Rusmali	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar (Kundër)